U bëjmë thirrje të gjithë qytetareve
dhe qytetarëve të na bashkohen
në orvatjet për vlera të gjelbra,
drejtësi sociale dhe kundër nacionalizmit

Varfëria, dhuna, korrupsioni, ndotja,
keqpërdorimet,
Ekstremizmi, politikat dhe praktikat
e dëmshme shkojnë Bashkë.
CIVILi i promovon vlerat e gjelbra, drejtësinë sociale
dhe antinacionalizmin si alternativë e
vetme e qëndrueshme për shoqërinë dhe shtetin,

Shteti dhe shoqëria duhet patjetër të përcaktohen
për vlerat e gjelbra, sipas të cilave do të
sigurohet ardhmëri
afatgjate dhe e qëndrueshme për të gjithë.

Tendencat iliberale, eksploatimi dhe shkelja
e të drejtave të punëtorëve dhe të drejtat sociale
të qytetareve dhe qytetarëve dihet të ndalen.
Kërkojmë shoqëri në të cilën sundon
drejtësia sociale.

CIVILi angazhohet për dekonstruimin e narativava
nacionaliste dhe veprimit vendosës kundër
ekstremizmit, përmes sundimit të drejtësisë,
demokracisë dhe respektimit të të drejtave
dhe lirive të njeriut.

CIVILi e zbaton projektin në partneritet me
Fondacionin Hajnrih Bell.

WWW.GREENCIVIL.MK
www.civilmedia.mk | www.drejt.mk | www.civil.org.mk

ЗЕЛЕНИТЕ ДОАЃААТ PO VIJNË TË GJELBRIT

www.greencivil.mk

KYÇU

BËHU PJESË E ARDHMËRISË TANI

Çdo kush mund të jetë pjesë e aksionit dhe të jep kontributin e çmueshëm në angazhimet për vlera të gjelbra, në kërkim të drejtësisë sociale dhe luftës kundër nacionalizmit.

Na informoni për të gjitha problemet në komunën tuaj, mendoni për zgjidhje.
Bashkë dhe zëshëmdo të kërkojmë përgjigje
në pyetjet dhe zgjidhje për problemet.
Nuk ka më kohë, as hapësirë për arsyetime.
E dime se ka zgjidhje, kërkojmë të zbatohen!

na ndiqni:

civil.mk | green.civi.mk

GreenCivil1 | CivilMacedonia

CIVIL MEDIA

DËRGONI KONTAKTET DHE PROPOZIMET TUAJ PËR VEPRIM

civil@civil.org.mk | 02/520 91 76

shtypur në letër të ricikluar

CIVIL | green civil

HEINRICH BÖLL STIFTUNG
SARAJEVO
Bosnia and Herzegovina | Albania | North Macedonia

PO VIJNË TË GJELBRIT

VLERA TË GJELBRA
DREJTËSI SOCIALE
ANTINACIONALIZËM

www.greencivil.mk

www.civilmedia.mk | www.drejt.mk | www.civil.org.mk

civil.mk | CivilMacedonia | CivilMacedonia

civil@civil.org.mk | 02 / 5209 176

greenfuture
LOADING

PO VIJNË TË GJELBRIT

VLERA TË GJELBRA

respektimi i dinjitetit dhe të drejtave të njeriut

liri

demokraci

barazi

sundimi i drejtësisë

antidiskriminim

drejtësi sociale dhe ekologjike

transformimi I shoqërisë në interesin e të gjithëve

gjendja ekonomike, sociale dhe mirëqenia ekologjike

kultivimi I diversitetit të botës natyrore

kuptoni më tepër në:

www.greencivil.mk

PO VIJNË TË GJELBRIT

CIVILI I GJELBËR është njësi (degë) e organizatës **CIVIL-Qendra për Liri,** e cila i promovon vlerat dhe strategjitë e gjelbra si opsionin e vetëm të qëndrueshëm për shoqërinë dhe shtetin.
Mbijetesa e demokracisë është e mundur vetëm me veprim të vendosur kundër nacionalizmit, korrupsionit dhe kërcënimeve hibride. Kjo nënkupton pjesëmarrje qytetare në proceset për vendimmarrje dhe ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe të lire në të cilën sundon drejtësia dhe respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut.
CIVILI I GJELBËR u bën thirrje të gjithë qytetareve dhe qytetarëve që i respektojnë dhe mbështesin këto vlera në tërësi, të bëhen pjesë e të GJELBËRVE – **Platformë qytetare për demokraci, antinacionalizëm dhe alternativa të gjelbra politike, shoqërore dhe ekonomike.**
Angazhimet themelore të të GJELBËRVE janë respektimi i dinjitetit njerëzor dhe të drejtat e njeriut, liria, demokracia, barazia dhe drejtësia ekologjike, transformimi I shoqërisë në interesin e të gjithëve, mirëqenie ekonomike, sociale dhe ekologjike dhe kujdesja për diversitetin e botës natyrore.
Të GJELBRIT i përfaqësojnë, mbrojnë dhe i promovojnë vlerat e gjelbra në shoqëri dhe në shtet.
Të GJELBRIT kërkojnë veprim të vendosur dhe afatgjatë kundër të gjitha formave të nacionalizmit dhe të gjitha derivateve militante dhe të dhunshme të tij.
Të GJELBRIT kërkojnë nga institucionet të bëjnë hapa të vendosura për parandalimin dhe sanksionimin e kërcënimeve hibride kundër demokracisë dhe veprimit të pakompromistë kundër të gjitha formave mbi çdo bazë dhe në cilindo nivel.
Të GJELBRIT ftojnë për llogaritje me korrupsionin në të gjitha nivelet në shoqëri dhe në shtet.

kuptoni më tepër në:

www.greencivil.mk

PO VIJNË TË GJELBRIT

Ne mundemi ti ndryshojmë gjendjet. Kemi të drejtë të jetojmë në shoqëri në të cilën institucionet kujdesen
në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetaret dhe qytetarët.
Dhe jo për interesin e qendrave të fuqive.
Kemi të drejtë për shoqëri të shëndoshë, të drejtë dhe të lire.
Kemi të drejtë të kërkojmë të marrim pjesë në kujdesin për ruajtjen e botës natyrore dhe resurseve natyrore.
Kemi të drejtë të kërkojmë që shteti të orientohet drejt burimeve të rinovueshme të energjisë dhe krijimin e kornizave ligjore për ekonomi të gjelbër dhe mjedis jetësor të shëndoshë.
Kemi të drejtë të kërkojmë mbrojtje nga pasojat shkatërruese të nacionalizmit dhe kërcënimeve hibride kundër demokracisë.

VLERA TË GJELBRA
DREJTËSI SOCIALE
ANTINACIONALIZËM

Kjo iniciativë është qytetare dhe jopartiake. Aktivitetet në këtë iniciativë janë pjesë e angazhimeve të CIVILIT TË GJELBËR për mbështetje të reformave demokratike, pjesëmarrjes qytetare, iniciativat e gjelbra dhe vlerat evropiane. Projekti Po Vijnë të Gjelbrit CIVILi e zbaton në partneritet me Fondacionin Hajnrih Bell. Qëndrimet dhe aksionet e CIVILit dhe të pjesëmarrësve në iniciativën për formimin e të GJELBËRVE janë përgjegjësi vetëm e iniciatorëve dhe implementuesve të projektit dhe jo patjetër përkojnë me ato të Fondacionit.